

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.18.12.2023*

18.12.2023

Ora, 10:57

**RENDI I DITËS**

**“Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr.97, datë 12.12.2023”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa, z. Ilirjan Rusmali,  
z. Koli Bele, z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, znj. I. Osmanaj
- **Parti Politike:** S’ka
- **Të tjerë:** KRIIK

**Z. E. Çefa:** Mirëdita të gjithëve, çelim seancën e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve për shqyrtimin paraprak dhe vlerësimin e elementëve të formës dhe përmbajtjes të kërkesës ankimore me numër 97, e depozituar në KQZ në datë 12.12.2023 me objekt: ankim kundër vendimit të KQZ-së të rrëzimit të kërkesës së Koalicionit “Bashkë Fitojmë” për të shpallur të pavlefshëm dhe përfundimin e parakohëshëm të mandatit të kryetarit të Bashkisë Kuçovë, zotit Kreshnik Hajdari. Ky vendim u njoftohet palëve dhe menjëherë Kryeministrit etj., etj., në lidhje me shqyrtimin e projektvendimit “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetdeklarues zotin Kreshnik Riza Hajdari, kryetar i Bashkisë Kuçovë, Qarku Berat, i propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë” pra, vendimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve i datës 14 nëntor 2023. Ky është një ankim i depozituar nga një grup deputetësh. Pas hedhjes në short, relator i kësaj çështje jam caktuar unë, anëtari Evis Çefa. Përpara se të fillojmë të verifikojmë prezencën, është prezent trupa e plotë e KAS-it, është prezent Sekretari

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.18.12.2023*


i Përgjithshëm i KQZ-së dhe administrata e tij. Nuk ka prezencë të palës ankimuese, megjithëse besoj se kanë marrë rregullisht dijeni apo jo?

**Z. Y. Merkaç:** Po, kanë marrë!

**Z. E. Çefa:** Pra, kanë rregullisht dijeni, por nuk janë paraqitur. Kjo gjithsesi nuk e pengon KAS-in që të procedojë në këtë fazë të shqyrtimit administrativ. Atëherë, përsa i përket elementeve të formës dhe përmbajtjes ju lutem, zoti Sekretar i Përgjithshëm, shkurtimisht ju jap fjalën për t'i relatuar ato, faleminderit!

**Z. Y. Merkaç:** Pranë Komisionit të Ankimimit dhe Sanksioneve është paraqitur një kërkesë ankimore me numër 97, e cila është e nënshkruar nga 19 deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, të cilët kërkojnë anulimin e vendimit 816, datë 14.11.2023 të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, i cili ka vendosur në përfundim të shqyrtimit administrativ, konstatimin se zoti Kreshnik Hajdari, kryetar i Bashkisë Kuçovë i propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste nuk përfshihet në kushtet e ndalimit për të ushtruar funksionin publik të kryetarit. Nga verifikimi paraprak i kërkesës, konstatohet se i mungojnë elementët e nenit 126 dhe konkretisht pika 1, germa "b", referimin e vendimit që ankimohet nuk është vendimi që ankimohet. Numri i vendimit të paktën..., ekstremitetet e vendimit. Gjithashtu kërkesës ankimore i mungon edhe... është në kundërshtim me nenin 130, pika "b", legjitimimi i ankuesit, nuk legjitimohen në ngritjen e kësaj ankese. Për këto arsye kërkojmë mos kalimin e kërkesës për shqyrtim. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.18.12.2023*

**Z. E. Çefa:** Po faleminderit. Nga kolegët ndonjë pyetje? Unë do të doja nga Sekretari i Përgjithshëm të na argumetonte pak shkurtimisht këtë propozimin përse i përket mos legjitimitetit të ankuesit. Pse nuk legjitimohet?

**Z. Y. Merkaj:** Se në Kodin Zgjedhor, në rregulloren e KAS-it janë parashikuar personat që kanë të drejtë të ankimohen kundër vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, të cilët janë: subjektet zgjedhore në periudhën zgjedhore dhe partitë politike të cilave u preken interesat e tyre të ligjshme, në rast se nuk jemi në periudhë zgjedhore. Në rastin konkret asnjë nga deputetët nuk ka interes të ligjshëm, nuk është subjekt zgjedhor dhe nuk është parti politike. Të gjitha interesat e këtyre deputetëve përfshihen ose mbrohen nga partitë ku janë rreshtuar.


**Z. E. Çefa:** Qartë, po zoti Braho!

**Z. L. Braho:** Kam edhe unë një pyetje për zotin Merkaj. Tani ne kemi një vendimmarrje të Komisionerit. Vendimmarrja e Komisionerit a është bërë për verifikimin e të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit? Pra, ka qenë ky objekt i vendimmarrjes?

**Z. Y. Merkaj:** Po! Komisioneri e ka marrë me vendim. Ekstremitetet e vendimit janë: vendimi nr. 816, datë 14.11.2023.

**Z. L. Braho:** Po, atëherë dakord për këtë pjesë. Tani unë dua ti referohem pak ligjit që njihet ndryshe, ligji i dekriminalizimit që në nenin 7 të tij parashikon: “Verifikimi i të dhënave të deklaruara në formularin e vetdeklarimit të parashikuar në nenin 5 të këtij ligji, kryhet sa herë që kjo kërkohet”, germa “a”. “Një e dhjeta e deputetëve për

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.18.12.2023*

një të zgjedhur në organet e bashkisë apo të qarkut...” thotë neni 7 germa “a”. A mund të jemi në këto kushte, meqë iniciuesi i kërkesës janë një e dhjeta e deputetëve? Këtu janë më shumë se 14, mesa pashë unë. Më duket se ishin 15 deputetë nënshkrues. A mund te gjendemi në kushtet e kësaj dispozite, në rastin objekt shqyrtimi?

**Z. Y. Merkaj:** Mesa lexoj neni 107, thotë: “E drejta e analizës për drejtim...” dmth duhet të jenë të paktën dhjetë përqind e deputetëve të Kuvendit të cilët do ta nisin këtë, do ta marrin iniciativën për ta bërë. Në rast se marrja e iniciativës dhe vendimmarrja e Komisionerit me nismën e 10 përqind të paktën e të gjithë deputetëve, do të ishte një vendimmarrje e cila nuk do t’i shkonte për shtat interesave të tyre, atëherë edhe mund të ankoheshin. Në këtë rast nuk kanë qenë pjese e procedurës administrative.

**Z. L. Braho:** Ti thua që nuk kanë qenë këta nismëtarët e procedurës pranë Komisionerit që kështu nuk mund të legjitimohen për ankim.

**Z. E. Çefa:** Dakord, atëherë faleminderit.

**Z. A. Llangozi, avokat:** Mundem?

**Z. E. Çefa:** Avokat jemi në kërkesë tjetër ankimore ju nuk jeni ende palë.

**Z. A. Llangozi, avokat:** Kam dijeni që deputetët kanë bërë ankim ndoshta...

**Z. E. Çefa:** Kjo është çështja e deputetëve, por ju nuk jeni palë këtu.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.18.12.2023*

**Z. A. Llangozi, avokat:** Kam bërë ankim, por kemi një interes të përbashkët. Po ju vë në dijeni që mos ta rrëzoni pa e verifikuar. Se e kam bërë ankimin e keni të sigurtë kam kopje të ankimit. E kanë iniciuar deputetët si fillim që në procesin zgjedhor.

**Z. E. Çefa:** Atëherë KAS-i do të tërhiqet për vendim për këtë kërkesë ankimore. Atëherë do t'ju kërkojmë 5 minuta.. ndjesë ju lutem se ju sa u sistemuat.

**Rifillon seanca**

**Ora 11:11**

**Z. E. Çefa:** Atëherë KAS i konsultuar në vend vendosi:

- Mos kalimin për shqyrtim të kërkesës ankimore me numër 97, datë 12.12.2023 e paraqitur nga një grup deputetësh, për shkak se KAS vëren se: duke qenë se grupi i deputetëve nuk ka qenë ai, që ka iniciuar këtë procedurë konkrete administrative në KQZ, pranë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për rrjedhojë ata nuk kanë legjitimitet aktiv për të paraqitur ankim përpara vendimit eventual të Komisionerit.

- Kundër këtij vendimi palët e interesuara mund të paraqesin ankim brenda afateve të parashikuara në ligj në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

Me kaq seancën e deklaroj të mbyllur dhe i jap fjalën kolegut Lako për kërkesën tjetër.

**Vendimi nr. 192**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.18.12.2023*

18.12.2023

Ora, 11:23

**RENDI I DITËS**

*“Për pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 95/1, depozituar nga subjekti zgjedhor “Partia e Lirisë” dhe për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 95/2, depozituar nga subjekti zgjedhor “Partia Demokratike e Shqipërisë”.*

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa, z. Ilirjan Rusmali, z. Koli Bele, z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, znj. I. Osmanaj
- **Parti Politike:** S’ka
- **Të tjerë:** KRIIK
- **Avokatë:** Z. Th. Sollaku, z. A. Llangozi, z. F. Nuri

**Z. E. Lako:** Mirë, çelim sot seancën e Komisionit të Ankimimeve e Sanksioneve për verifikimin e elementëve të formës dhe përmbajtjes për kërkesën ankimore nr. 95, datë 16.11.2023, të paraqitur nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë” me objekt: ankim kundër vendimit të KSHZ-së për të shpallur të pavlefshëm dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të kryetarit të Bashkisë Kuçovë, zotit Kreshnik Hajdari. Ky vendim i njoftohet menjëherë kryeministrit etj. Mbështetur në përcaktimet e nenit 129 të Kodit Zgjedhor sipas shortit të hedhur datë 22.11.2023 relatori i kësaj seance jam zgjedhur unë, Edvin Lako. Të pranishëm në këtë seancë janë anëtarët e Komisionit të Ankimimeve e Sanksioneve, Sekretari i Përgjithshëm dhe administrata e KQZ-së. Përpara fillimit të seancës për verifikimin e elementëve të formës dhe


*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.18.12.2023*

përmbajtjes të datës 23.11.2023 ora 11, pas relativitetit të çështjes objekt shqyrtimi, u konstatua se kërkesa ankimore nuk i plotësonte elementët e formës të parashikuar në nenin 126, pasi ishte paraqitur me të meta. Konkretisht ankimimi duhet të depozitohet nga partia politike, pasi pas certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve dhe vendore të datës 14 maj 2023, koalicionit i ka përfunduar personaliteti juridik. Gjithashtu, afati i ankimimit ndaj vendimarrjes së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve përfundonte në datë 14.12.2023. Kështu trupa e KAS-it në unanimitet vendosi: kthimin e kërkesës ankimore nr. 95 datë 16.11.2023, për plotësimin e elementëve të formës brenda 24 orëve nga shpallja e këtij vendimi. Në përmbushje të këtij detyrimi të përcaktuar në vendimin nr. 191, në datë 23.11.2023 në protokollin e KQZ-së janë administruar dy shkresa me nr. 7722 protokoll, datë 24.11.2023 me ankues Partia e Lirisë, përfaqësuar nga nënkryetari zoti Brahimllari, regjistruar me numrin e kërkesës ankimore 95/1, në vijim të kërkesës ankimore nr. 95. Gjithashtu dhe kërkesa tjetër nr. 7724 protokoll, datë 24.11.2023, me ankues Partia Demokratike e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm zoti Noka, regjistruar me nr. 95/2 në vijimësi të kërkesës ankimore nr. 95. Në lidhje me këto dy kërkesa që janë depozituar në KQZ është njohur trupa e KAS-it, një kopje të së cilës duhet t'i kemi përpara. Shkurtimisht zoti Sekretar i Përgjithshëm, keni ndonjë koment në lidhje me këto dy kërkesa në vijim dhe të detyrës që u la në seancën e fundit nga KAS?

**Z. Y. Merkaç:** Sipas urdhërit të KAS-it të dyja partitë politike kanë plotësuar të metat e ankimit. Kërkesa 95/1 me ankues Partia e Lirisë, i plotëson kërkesat e formës dhe përmbajtjes parashikuar në nenin 126 dhe 130 të Kodit Zgjedhor, ndërsa kërkesa tjetër nuk i plotëson kërkesat e kërkuara nga neni 130 i Kodit Zgjedhor, kjo pasi Partia Demokratike e Shqipërisë me sekretar Flamur Nokën, nuk ka personalitet

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.18.12.2023*

juridik dhe nuk mund të bëjë ankimim. Në këto kushte kërkojmë kalimin për shqyrtim të kërkesës me ankues Partia e Lirisë e cila ankimon vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 816 dhe rrëzimin e kërkesës me ankues Partia Demokratike e Shqipërisë me Sekretar të Përgjithshëm zotin Flamur Noka, faleminderit.


**Z. E. Lako:** Mirë, falemiderit zoti sekretar. Për palën ankuese ju lutem shkurtimisht me elementët e formës dhe përmbajtjes.

**Z. A. Llangozi, avokat:** Për Partinë e Lirisë, avokat Arben Llagozi. E kam autorizimin për ditën e sotme, e paraqes.

**Z. E. Lako:** Qartë kjo ishte pjesa e legjitimitetit. Përsa i përket kërkesës, dy fjalë fillimisht që i plotëson kërkesat për kalimin në seancë apo jo?

**Z. A. Llangozi, avokat:** Normal kërkesa ashtu siç ne i kemi parashtuar i plotëson kriteret për kalimin për shqyrtim, për arsye se kemi interes në mënyrë të drejtpërdrejtë në lidhje me këtë çështje. Nqs kjo kërkesë pranohet, interesi ynë është i ligjshëm që do të ripërsëriten zgjedhjet në njësinë vendore ku aktualisht, kryetari i Bashkisë Kuçovë ka bërë një deklaram të rremë për të cilën është marrë dhe i pandehur. Për këtë arsye, ne konsiderojmë që kjo kërkesë të bazohet në faktin e paligjshmërisë të kryer nga zoti Kreshnik Hajdari, e konstatuar nga Prokuroria e Përgjithshme nëpërmjet shkresës që i është drejtuar KQZ-së, njëkohësisht dhe Prokuroria e Posaçme që është duke vijuar shqyrtimin e saj. Për këtë arsye mendojmë se ana formale është e duhur dhe duhet të kalojë për gjykim.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.18.12.2023*

**Z. E. Lako:** Mirë faleminderit zoti Llangozi. Përsa i përket kërkesës tjetër.


**Z. F. Nuri, avokat:** Po faleminderit zoti Lako, jam sot këtu me autorizimin e Sekretarit të Përgjithshëm zoti Noka, të Partisë Demokratike, për të ndjekur seancën e sotme lidhur me ankimimin që ky subjekt ka kryer në funksion të Koalicionit “Bashkë Fitojmë”. Ne gjithashtu gjykojme se pavarësisht dilemave që ka pasur dhe herë të tjera lidhur me këtë çështje, mendojmë që i plotësojmë kriteret e formës dhe përmbajtjes për të qenë pjesë e këtij ankimi dhe për të shprehur mendimin tonë dhe në themelin e çështjes. Faleminderit!

**Z. E. Lako:** Faleminderit, Meqenëse jemi këtu te kërkesa e subjektit tjetër pra, me përfaqësues zotin Noka, mund të na thoni dy fjalë shtesë pse ju mendoni që do keni interes të ligjshëm te kjo pjesa e interesit të ligjshëm?

**Z. F. Nuri, avokat:** Po ne mendojmë që kemi interes të ligjshëm sepse e kemi ndjekur këtë çështje që në fillim në kuadër të Koalicionit “Bashkë Fitojmë”. Përderisa koalicionit i mbaroi personaliteti juridik sipas udhëzimeve dhe informacionit që ju na dhatë herën e kaluar në KAS, në seancën e muajit të kaluar, rrjedhimisht dhe ne si subjekt pjesë e koalicionit, vendosëm që të paraqesim ankim në mënyrë që të legjitimohemi për të vazhduar dhe për të qenë prezent dhe për të ndjekur të gjitha këto seanca.

**Z. E. Lako:** Mirë, faleminderit. Nga anëtarët e KAS-it ka ndonjë pyetje? Nuk ka! Kalova.., sepse herën tjetër e legjitimuam pjesën e palës së interesuar. Ka ndonjë kërkesë në këtë fazë nga pala e interesuar? Nuk ka! Mirë, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.18.12.2023*

Atëherë KAS për këto dy kërkesa, do të tërhiqet për vendim dhe do t'ju thërrasim përsëri, besoj për 10 minuta, për të shpallur vendimin, faleminderit!

**Rifillon seanca**

**Ora, 11:31**

**Z. E. Lako:** Mirë e çelim dhe njëherë seancën. Atëherë, KAS pasi dëgjoi me vëmendje dhe mori parasysh pretendimet e palëve, bazën ligjore dhe provat e administruara vendosi që:

- Të kalojë për shqyrtim ankimin e bërë nga subjekti zgjedhor Partia e Lirisë, ndërsa me shumicë votash vendosi:

- Moskalimin e ankimit të bërë nga subjekti zgjedhor i përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm Flamur Noka, për shkak se nuk ka qenë pjesë e koalicionit.

- Kundër vendimit të KAS mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda afateve për mospranimin sipas ligjit.

Përsa i përket seancës së themelit ndonjë sugjerim nga palët kur të lemë ndonjë datë që është e pranueshme dhe për ju, si e mendoni? Për palën ankuese Partia e Lirisë?

**Z. A. Llangozi, avokat:** Ditën e premtë.

**Z. E. Lako:** Ne kemi një procedurë që duhet të kalojë një afat nga kjo seancë në seancë themeli, 24 orë të paktën. Kështu edhe për palën e interesuar, për të premtën nuk është një nga anëtarët e KAS-it.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.18.12.2023*

**Z. A. Llangozi, avokat:** Të enjten e kemi ne të zënë ditën, të hënën!? Në janar, në datë 5 janar!

**Z. E. Lako:** Atëherë, KAS i konsultuar edhe me palët vendosi seancën e shqyrtimit më 5 janar 2024, ora 10:30. Me kaq e deklarojmë të mbyllur seancën, faleminderit!

**Vendimi nr. 193**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.18.12.2023*

18.12.2023

Ora, 11:36

**RENDI I DITËS**


**“Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 96, datë 4.12.2023, të depozituar nga Organizata Qendra “Qëndresa Qytetare”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa, z. Ilirjan Rusmali, z. Koli Bele, z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, znj. I. Osmanaj.
- **Parti Politike:** S’ka
- **Të tjerë:** **KRIIK, z. R. Xhemollari (Qëndresa Qytetare)**  
**z. Dëfrim Korbi, Sekretar i Përgjithshëm**  
**Bashkia Kukës.**

**Z. E. Lako:** Mirë çelim seancën e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve për verifikimin dhe plotësimin e elementëve të formës dhe përmbajtjes për kërkesën nr. 96, datë 04.12.2023 të paraqitur nga Organizata Qëndresa Qytetare me objekt: kundërshtimin e vendimit nr. 811, datë 20.10.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Sipas përcaktimeve të nenit 129, të Kodit Zgjedhor, në shortin e hedhur më datë 11.12.2023, relator i kësaj seance jam zgjedhur unë Elvin Lako. Të pranishëm në seancë janë anëtarët e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, Sekretari i Përgjithshëm dhe administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Përsa i përket palës së interesuar ju lutem?

**Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU**




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.18.12.2023*

**Z. R. Xhemollari, përfaqësues i Qëndresës Qytetare:** Rigers Xhemollari, drejtor ekzekutiv Qëndresa Qytetare.

**Z. E. Lako:** Besoj administrata e keni të verifikuar përfaqësuesin e organizatës, sepse nuk është hera e parë që shqyrtojmë. Duhet të keni parasysh se seanca e sotme ka të bëjë vetëm me plotësimin e elementëve të formës dhe përmbajtjes pa i hyrë themelit të çështjes. Shkurtimisht zoti Sekretar i Përgjithshëm, dy fjalë në lidhje me plotësimin e elementëve të formës dhe përmbajtjes për këtë kërkesë ankimore. Pra, legjitimohet apo jo ankuesi, a është bërë brenda afeteve ligjore të përcaktuara?

**Z. Y. Merkaj:** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka shqyrtuar në seancë administrative denoncimin e bërë nga Organizata Qëndresa Qytetare për ndalimin e aktivitetit të kandidimit, të kandidatit të Partisë Socialiste për zgjedhje të pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023. Në përfundim të shqyrtimit administrativ, Komisioneri ka vendosur pushimin e hetimit administrativ dhe mos konstatimin e shkeljes për zotin Albert Halilaj, kandidat për kryetar i Bashkisë Kukës, i propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë. Vendimi është marrë më datë 20 tetor 2023, ku prezent kanë qenë të gjitha palët përfshirë edhe kërkuesin Organizata Qëndresa Qytetare. Nga shqyrtimi i elementëve formalë të kërkesës, konstatohet se i plotëson të dy kërkesat e nenit 130 të Kodit Zgjedhor në lidhje me kompetencën e KQZ-së për shqyrtimin e ankimit si dhe legjitimitimin e ankuesit në ngritjen e kësaj kërkesë ankimore. Nuk plotëson kërkesën, germën “c” për respektimin e afatit për ankim, pasi është depozituar jashtë afatit të ankimit. Në këto kushte i kërkojmë KAS-it, mos kalimin e kërkesës ankimore në seancë shqyrtimi. Ju faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt.18.12.2023*

**Z. E. Lako:** Pra, dhe një herë zoti Merkaj ju lutem në lidhje me këtë të afatit të ankimit, ju kujt i referoheni? Na e sqaroni më qartë!

**Z. Y. Merkaj:** Atëherë, në seancë Komisioneri ka marrë në shqyrtim administrativ dhe ka shpall vendimin në seancë ku palët kanë qenë prezent. Vendimi është shpallur në datë 20 tetor. Kundër këtij ankimi mund të bëhet ankim brenda 30 ditëve. Afati i fundit i ankimit pasi palët kanë marrë njoftim për vendimarrjen e Komisionerit, ka qenë data 30 nëntor 2023. Ankimi është paraqitur më datë 4 dhjetor 2023. Katër ditë pas kalimit të afatit të ankimit. Më 20 tetor është shpallur vendimi.

**Z. E. Lako:** Mirë, në lidhje me palën që ka paraqitur ankimin, keni ndonjë koment në lidhje me elementët e formës dhe përmbajtjes sidomos për pjesën e afatit?

**Z. R. Xhemollari, përfaqësues i Qëndresës Qytetare:** Në fakt unë sapo u njoha me këtë konstatim, sepse sot nuk e kam as juristin. Mendova se ishte thjesht për pjesën formale. Nëse mund të bëj një konsultim?


**Z. E. Lako:** Patjetër dy minuta dhe e rifillojmë përsëri.

**Rifillon seanca**

**Ora, 11:42**

**Z. E. Lako:** Rifillojmë seancën, po zoti Xhemollari!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.18.12.2023*

**Z. R. Xhemollari, përfaqësues i Qëndresës Qytetare:** Nuk kam një përgjigje për momentin, por ndoshta i është referuar datës 2 nëntor. Nëse është tejkaluar nuk e di pastaj, ju e dini.

**Z. E. Lako:** Ju keni bërë ankim në datë 4, vendimi është shpallur në seancë në datë 20 tetor dhe me afat ju duhet ta sillnit brenda 20 nëntorit.

**Z. R. Xhemollari, përfaqësues i Qëndresës Qytetare:** Mund ta na ndihmoni dot me një kopje të vendimit? Sipas juristit ankimimi është dërguar në datë 1 ose 2 dhjetor me e-mail dhe është protokolluar në datë 4 dhjetor nga KQZ-ja.

**Z. E. Lako:** Po për pjesën që keni marrë njoftim që keni qenë në seancë. Dikush nga ju ka qenë në seancë është edhe në procesverbal edhe e evidentuar.


**Z. R. Xhemollari, përfaqësues i Qëndresës Qytetare:** Po, po. Ka qenë në seancë. I jemi referuar vendimit të zbardhur.

**Z. E. Lako:** Ju i jeni referuar datës kur ju ka ardhur zyrtarisht vendimi?

**Z. R. Xhemollari, përfaqësues i Qëndresës Qytetare:** Po, vendimi i zbardhur.

**Z. E. Lako:** Mirë, ka ndonjë pyetje tjetër nga anëtarët e KAS-it? S'ka! Do të tërhiqemi 5 minuta për vendim dhe do ta shpallim.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.18.12.2023*

**Rifillon seanca**

**Ora, 11:51**

**Z. E. Lako:** Atëherë Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve pasi dëgjoji dhe mori parasysh pretendimet e palëve, bazën ligjore dhe provat e administruara vendosi:

- Moskalimin e kësaj çështje për shqyrtim, për shkak se është bërë jashtë afatit ligjor.
- Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, sipas ligjit.

Me kaq e deklarojmë të mbyllur seancën e sotme. Faleminderit.

**Vendimi nr. 194**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

